# TË DËNUAR ME VDEKJE NGA .... SHTETI !

**Nga Ferdinand Dervishi**

***Në kushtet e një pasigurie në rritje, ish oficerë të lartë të Policisë së Shtetit të larguar nga radhët e saj, janë vënë në shënjestër të krimit si në rastin e Xhavit Shalës. Jo sepse kanë tejkaluar me zbatimin e ligjit, por se shteti nuk ka arritur t'i mbrojë.***[1]

Duke u zhvendosur me makinën që kishte një bombë me telekomandë të montuar në shasi, ditën që e gjeti, Xhavit SHALA, një prej drejtuesve më të njohur të policisë shqiptare, e kishte parkuar atë në Durrës pranë vendtakimit me shkrimtarin më të madh shqiptar, më pas me një ministër të njohur…, më tej, duke bartur vdekjen me vete, ai kishte hipur e zbritur shumë "pasagjerë", përfshirë dhe një grua me 4 fëmijë të vegjël. Por bomba, mbase për një kapriçio të fatit, kishte vendosur të heshtte. Pas vetëshpërthimit pak muaj më parë në afërsi të banesës së Shalës, në rrugën "Don Bosco", të një njeriu, i cili po mundohej të vinte një tjetër bombë me telekomandë, mina nën makinë u kuptua që ishte tentativa e dytë për të hequr qafe një njeri, që dikur me punën e vet duke i shërbyer shtetit, kishte bërë shumë armiq.

"Zoti të ruan dy herë, por jo tre herë", i thanë shumë miq Shalës pasi mësuan për ngjarjen, duke këmbëngulur që ai të ndërmerrte një ndryshim radikal, qoftë duke u larguar jashtë shtetit. Por ish drejtuesi i Policisë Kriminale të gjithë Republikës dhe ish drejtori i policisë së Fierit e Lezhës, këtë radhë vërtet i lodhur, ngre supet dhe thotë i shpërqendruar: "Më falni, por për mua duhet të mendojë shteti". "Të paktën na trego se kush janë ata që të duan të vrarë, se do dimë edhe ne t'u përgjigjemi me të njëjtën gjuhë", i luten djem të rinj nga fisi i zgjeruar. Por, përsëri, oficeri i vjetër tund kokën, duke mos miratuar e përsëritur : I takon shtetit të mendojë e të marrë masa…. .

## Reforma pa kokë

Në fakt kjo histori, më saktë ky atentat i dytë i dështuar i krimit ndaj një ish oficeri të lartë të policisë, mund të konsiderohet si kulm i një kundërpërgjigje të krimit që ka fokusuar pikërisht këta ish drejtues, të cilët, të hedhur në rrugë nuk kanë atë mburojën që të jep detyra. Janë të paktën 10-13 drejtues të lartë dhe rreth 70 të mesëm të policisë, që gjenden në të njëjtën pozitë si dhe Shala, të gjithë viktima të një reforme pa krye të iniciuar nga ministri aktual i rendit Igli Toska…

## Shteti nën akuzë

…Të shtunën e kaluar, më 13 gusht, ditën që Xhavit Shala duke menduar për miqtë e shumtë, kishte futur në bagazhin e makinës 50 kopje të librit të tij të

[1] Shkrimi është botuar ne numrin 423 të Revistës "Klan", datë 27 Gusht 2005, ne faqet 21-23

fundit të titulluar “Antikanabis apo kanabopolitikë”. I mbetur pa punë Shala i ishte përveshur hobit të tij të dytë, letrave. Pa e menduar gjatë se, pikërisht, pas publikimit të lajmit të përjashtimit nga policia dhe, njëkohësisht, mbetjes pa atë mbrojtjen që të jep detyra, dikujt do t’i hapej oreksi për të realizuar një dëshirë të vjetër djallëzore.

Porse jo të gjithë ish drejtuesit e lartë të policisë i kanë bërë publike shqetësimet e tyre nga krimi. Shumë prej tyre, pasi kanë bërë llogaritë, u ka dalë më mirë t’u dalin për zot situatës. Në shumë raste ata kanë përdorur kërcënime të së njëjtës gjuhë me kriminelët, u kanë dërguar mesazhe se janë aq trima sa edhe ishin kur mbanin veshur imunitetin e uniformës, apo u kanë rrëfyer se, në rast të nisjes së “lojës”, probabiliteti për të humbur ishte për të dy palët. Gjithsesi, Shala kishte besuar se shteti do ta mbronte, prandaj kishte pranuar një truprojë të vendosur prej tij, por në situatën e krijuar, kur veprimet dhe forcat e Policisë së Shtetit duket se po zbehen, në pamje të parë duket se do të kishte qenë më efikase për ish oficerin e lartë të policisë.

Xhavit Shala me punën e tij në vitin 1998, kohë kur ishte në krye të degës së Shërbimit Sekret Shqiptar (SHISH) në Elbasan, ishte protagonist i zbulimit të një rrjeti të terrorizmit ndërkombëtar, celulë e Xhihadit Islamik Egjiptian dhe e shkrirë në një me Al Kaedën.

Më tej, në vitet 1999-2000, i njëjti duke drejtuar policinë e Fierit, do të bëhej hartuesi i një strategjie antikanabis e, pas saj, edhe i një strategjie tjetër për trafikun e femrave për prostitucion. Pra, kudo ku kishte punuar, njeriu që në pamje të parë nuk dallon nga humanoidët e tjerë, kishte arritur të ishte i pari, të paktën për vlerën e arkëtuar për llogari të shtetit. Porse shteti jo gjithmonë, madje në shumë pak raste, ka qenë i kujdesshëm me njerëzit që i kanë shërbyer me besnikëri.

Tentativa e dytë, e para pak ditëve për ta vrarë, tregoi se dikush e ka shumë seriozisht dhe është i interesuar që ish kryepolici të mos jetë mes të gjallëve. Menjëherë më pas Shala është parë në shoqërinë e dy truprojave të forcave speciale. Kaq ishte dhe interesimi i shtetit pas tentativës së dytë për ta vrarë. Asnjë alternativë, asnjë propozim i strukturave të ndryshme që duhet të fillojnë nga Ministria e Rendit, për ta larguar për ca kohë nga Tirana bashkë me familjen, nëse nuk do të ngatërrohen këtu propozimet private të disa miqve. Dhe ç’është më e dhimbshmja në gjithë këtë histori, asnjë telefonatë për atë që i ndodhi nga asnjë prej krerëve të Ministrisë së Rendit.

Një fakt domethënës që, nëse do ta krahasosh me traditën shqiptare, do të duhet të nxjerrësh një përfundim të frikshëm : Në ngushëllim nuk vijnë zakonisht vetëm ata që janë kujdesur të të bëjnë gropën. Qoftë kjo me veprime apo me mosveprime.






Në faqen tjetër, pallati ku banon komisar Xhavit Shala shtëpia e të cilit ishte në shënjestrën e një atentati me minë të telekomanduar me celular në mars 2005. Pak ditë më parë në makinën e tij (fotot majtas) u gjet një sasi eksplozivi c4 e lidhur me një celular.

